




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 60 datë 26.10. 2020

Miratimin e planit për përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen nga izolimi i zonave malore nga dëbora dhe përmbytjet e mundshme në territorin e Bashkisë Vau-Dejës gjatë periudhës së dimrit.

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji Nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile”. Neni 14 Pika 2,3,6 Ligji Nr.152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, Ligji Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

Pas diskutimit dhe miratimit me shumice të cilësuar votash,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. **Miratimin** e planit për përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen nga izolimi i zonave malore nga dëbora dhe përmbytjet e mundshme në territorin e Bashkisë Vau-Dejës gjatë periudhës së dimrit.
2. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banoreve të dëmtuar.
3. **Burimi i financimit:** Fondi i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “i cili është miratuar në Buxhetin e Bashkisë sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.92 dt.24.12.2019 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2020.
4. Ngarkohen komisioni i vendor i Emergjencave Civile i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me Nr. **290** prot , dt.12.10.2020 për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

ZV/ KRYETAR

Ervis Shimoj

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Arjana Çelepy


Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 30.10.2020





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT VENDIM
Nr. 11 datë 16/10/ 2020

Pwr

Miratimin e planit për përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen nga izolimi i zonave malore nga dëbora dhe përmbytjet e mundshme në territorin e Bashkisë Vau-Dejës , gjatë periudhës së dimrit.

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji Nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile”. Neni 14 Pika 2,3,6 Ligji Nr.152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, Ligji Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të qenë të përgaditur përballë situatave emergjente që mund të krijohen gjatë periudhës dimërore i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

V E N D O S I :

- 1. Të miratojë** planin për përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen nga izolimi i zonave malore nga dëbora dhe përmbytjet e mundshme në territorin e Bashkisë Vau-Dejës gjatë periudhës së dimrit.
- 2. Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorëve të prekur.
- 3. Burimi i financimit** do të jetë fondi i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “i cili është miratuar në Buxhetin e Bashkisë sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.92 dt.24.12.2019 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2020.

Konfirmoi bazen ligjore

Kristine SHTATRI

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

KRYETARI

Mark BARANI

